



Në bazë të nenit 11 (njëmbëdhjetë) të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 02/2016, Drejtoria e shkollës shpallë:

FTESË PËR OFERTË

Pas vendimit të marrë nga Këshilli Drejtues i Shkollës, ftojmë të gjitha agjencitë turistike të marrin pjesë në ftesën për ofertë të ekskursionit të maturantëve të IAAP "Skënder Luarasi" në Suharekë.

Ekskursioni do të zhvillohet në Republikën e Shqipërisë nga fundi i shtatorit ose fillimi i tetorit 2024.

Kohëzgjatja e ekskursionit është 4 (katër) netë (pansione të plota).

Në ekskursion do të marrin pjesë 190 nxënës.

Në ofertë parashihet çmimi i akomodimit, ushqimit (mëngjesi + dreka + darka), çmimi i transportit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në muze dhe kala që parashihen në rrugëtimin e përcaktuar nga Këshilli i Shkollës.

Agjencionet turistike që konkurrojnë duhet t'i plotësojnë këto parakushte:

1. Agjencioni duhet të ketë licencën " D " nga Ministria. Ofertës t'i bashkëngjiten fotokopjet e këtyre dokumenteve.
2. Të ketë bërë kontrollin teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore-Ofertës t'i bashkëngjiten dëshmitë për këtë për të gjithë autobusët që do të përdorën në ekskursion.
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e ekskursionit
4. Duhet të ofroj dëshmi për akomodimin në Hotel në të cilin plotësohen kërkesat e Këshillit Drejtues të Shkollës dhe Prindërve (Siguria, Rrethojat, Ushqimi, Ballo për aktivitete të lira, projektor, hapësirë e dedikuar e promovimit të projekteve të nxënësve, si dhe duhet që nxënësit të akomodohen brenda një objekti).
5. Për shoferët e angazhuar në ekskursion nga agjencioni duhet të kenë certifikatën e mjekut, CPC-në dhe kopjet e patentshoferit.
6. Agjencioni duhet të siguroi përkujdesje mjekësore për pjesëmarrësit e ekskursionit gjatë tërë kohëzgjatjes së tij. Ofertës t'i bashkëngjiten leja e punës e mjekut dhe fotokopja e kontratës për përkujdesje gjatë tërë kohëzgjatjes së ekskursionit.
7. Afati i konkurrimit 7 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit, ofertat dorëzohen në DKA- Suharekë.
8. OE i kërkohet të bëjë një konfirmim me shkrim që do të jetë në gjendje të mënjanoi shpejtë prishjet eventuale të ndonjë autobusi ose nëse është e nevojshme pa vonesë ta zëvendëson atë autobus.
9. Dokumentet jashtë afatit të paraparë nuk pranohen.
10. Dokumentet jo komplete nuk shqyrtohen.

Fituesi i ofertës do të zgjidhet operatori ekonomik, i cili i plotëson të gjitha kriteret e mësipërme dhe ka ofertën më të mirë, vlerësuar nga Komisioni, përbërja e të cilit është përcaktuar me UA 02/2016.

-Formulari i paraqitjes së ofertës dhe rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës merren në IAAP "Skënder Luarasi" nga data 10.09.2024 ora 08.00-13:00.

Pranimi i ofertave bëhet nga data 10.09.2024 deri më 17.09.2024 deri në ora 13:00 në DKA-Suharekë. Hapja e ofertave bëhen në DKA-Suharekë me datë: 17.09.2024 në ora 13:30.

Suharekë, 10.09.2024

Drejtori:
Hamdi Bytyqi

Rr.: "Gjergj Kastrioti-Skenderbeu" 23000 Suharekë, Kosovë

TEL 049889956, e-mail: shmskenderluarasi@gmail.com

